Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 11.5.2021, në orën 10.00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-10

P R O C E S V E R B A L

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralia, Mirlinda Sadiku, Eman Rrahmani, Fadil Nura, Hajdar Beqa, Enver Haliti, Jetmire Vrenezi, Bekim Arifi dhe Albana Bytyçi.

Mungoi: Jasmina Dediq.

Stafi mbështetës i komisionit: Antigona Ibraj dhe Mehmet Simnica.

Të ftuar: Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, tutje ASK-së.

Pjesëmarrësit tjerë: Vlora Spanca, Samir Zymberi dhe Arbrore Sheremeti nga ZKA-ja.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.4.2021;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve;
4. Të ndryshme.

Mbledhjen e kryesoi Hykmete Bajrami, *kryetare e komisionit, e cila pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.4.2021**

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 27.4.2021, u miratua pa vërejtje.

3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve**

Hykmete Bajrami, kryetare, tha se ky raport i auditimit të teknologjisë së informacionit është bërë për të vlerësuar nëse Divizioni i Teknologjisë së Informacionit ka arritur të menaxhojë operacionet dhe sistemet elektronike për të mbështetur arritjen e objektivave të planifikimit strategjik të ASK-së. Në kuadër të këtij ZKA-ja ka vlerësuar nëse ASK-ja ka vendosur mekanizmat e nevojshëm për kontrollet e përgjithshme të TI-së, që përfshijnë mjedisin e përgjithshëm në të cilin aktivitetet e TI-së janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur. Rezultatet e auditimit tregojnë se Agjencia përmes sistemeve të teknologjisë së informacionit në përgjithësi ka arritur të realizojë dhe të publikojë projektet statistikore të parapara me planin e publikimeve. Megjithatë, nuk kishte vendosur mekanizmat e nevojshëm për kontrollet e përgjithshme të teknologjisë së informacionit, që përfshijnë mjedisin në të cilin aktivitetet janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur. Auditorët me këtë auditim kanë dhënë një numër të konsideruar të rekomandimeve, për të diskutuar detajet nga ky raport, atëherë fjalën ia kaloi Arta Bajraliut, në cilësinë e deputetes raportuese dhe me këtë e hapi diskutimin.

Arta Bajraliu, theksoi se siç thuhet edhe në raport të auditimit, ky auditim përfshinë vitin 2019, ndërsa viti 2020 është mbuluar deri në muajin shkurt. Rezultatet e auditimit tregojnë se Agjencia përmes sistemeve të teknologjisë së informacionit, në përgjithësi ka arritur të realizojë dhe të publikojë projektet statistikore të parapara me planin e publikimeve. Megjithatë, nuk kishte vendosur mekanizmat e nevojshëm për kontrollet e përgjithshme të teknologjisë së informacionit, që përfshijnë mjedisin në të cilin aktivitetet janë zhvilluar, operuar, menaxhuar dhe mirëmbajtur. Ka mungesë të vlerësimit adekuat të nevojave në fushën e teknologjisë së informacionit, ndarje joadekuate të detyrave dhe përgjegjësive të stafit si dhe ka staf të pamjaftueshëm të teknologjisë së informacionit. Po ashtu, menaxhimi i aktiviteteve të teknologjisë së informacionit nuk është mjaftueshëm i bazuar në politika, procedura dhe procese të operimit. Agjencia nuk kishte ndërmarrë hapat e mjaftueshëm për t'u siguruar që informacioni i përpunuar nuk ekspozohet ndaj palëve të paautorizuara. Mungojnë politikat që trajtojnë çështjet e sigurisë së informacionit si dhe ndërgjegjësimi mbi kërkesat e përgjithshme të sigurisë së informacionit nga personeli i Agjencisë ka rezultuar i mangët. I gjithë procesi i punës, apo thënë ndryshe natyra e punës së Agjencisë së

Statistikave të Kosovës është e ndërlidhur ngushtë me fushën e teknologjisë. Kalimi i mbledhjes së të dhënave në mënyrë elektronike nga pyetësorët dhe anketat fizike në ato elektronike e deri te përpunimi dhe publikimi i të dhënave përmes aplikacioneve dhe softuerëve, dëshmojnë rëndësinë e teknologjisë. Avancime të tilla bëhen mbi bazën e nevojës së brendshme dhe të jashtme në kuptimin e publikimit të rezultateve sa më profesionale për palët e interesit, dhe gjithashtu mbi domosdoshmërinë e zotimit të burimeve njerëzore profesionale në njërën anë dhe në anën tjetër të zotimit të pajisjeve dhe sistemeve adekuate teknologjike. Një Agjenci me një rol të veçantë dhe të rëndësishëm duhet të menaxhojë dhe kontrollojë me shumë kujdes me detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të punës, në mënyrë që të ngrihet përgjegjësia dhe llogaridhënia për gjithsecilin. Përcaktimi i detyrave të punës është thelbësor si për punëdhënësin ashtu edhe për punëmarrësin. Nëse këto elemente nuk janë të përcaktuara dhe të koordinuara, atëherë do të ketë mungesë të kontrollit, monitorimit, vlerësimit dhe përgjegjësisë. Raporti e thekson mungesën e përcaktimit të detyrave të punës dhe përgjegjësive adekuate si dhe ndikimin e tyre në mosarritjen e realizimit të qëllimit dhe objektivave apo edhe gabimet, keqpërdorimet eventuale të pozitës së punës, duke mos i kryer detyrat për të cilat stafi adekuat është përcaktuar. Hartimi i procedurave dhe mekanizmave me qëllim të identifikimit të ngecjeve, incidenteve dhe problemeve tjera në sistemin e informacionit do të mundësonte në parandalimin e problemeve në të ardhmen si dhe do të krijoheshin procese për trajtimin, menaxhimin dhe historinë e incidenteve. Historiku mbi problematikat në sistemin e informacionit mund të ndikojë në mostrajtim, mosidentifikimin e saktë dhe trajtimin me kohë, lë mundësinë e mosanalizimit të shkaqeve të tyre sistemore, të cilat mund të çojnë në probleme në të ardhmen, si dhe lë mundësinë e mosminimizimit të ndonjë problemi apo incidenti që mund të ndodhë dhe mund të ketë pasoja në sistemet e TI-së.

Ilir Berisha, në detale dha sqarime për rekomandimet e ngritura nga Auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit në raportin e auditimit. ASK-ja është pajtuar me të gjeturat, nga 16 rekomandime, 9 prej tyre janë adresuar, 3 nga këto janë në proces të adresimit dhe 4 të tjera i kalojnë kompetencat e ASK-së.

Hykmete Bajrami, kryetare, tha se 4 rekomandime i kalojnë kompetencat e ASK-së, cilat institucione kanë ndikim në to dhe çka duhet të bëjë KMFP-ja për të shtuar ndikimin në këto institucione për t'ju ndihmuar në adresimin e plotë të këtyre rekomandimeve.

Hajdar Beqa, theksoi se numri i madh i të gjeturave dhe angazhimin i juaj për adresimin e të gjeturave është për tu inkurajuar. Mirëpo, pyeti se nga 4 rekomandime që i tejkalojnë kompetencat e ASK-së, njëri nga to ka të bëjë me udhëzimin administrativ, nëse ka të bëjë me mungesë të buxhetit atëherë do të duhej që KMFP-ja të ndihmojë në këtë proces.

Eman Rrahmani, pyeti se sa zyrtarë të TI janë të punësuar në ASK, si dhe pse sipas auditorit nuk kanë përshkrim të saktë të detyrave të punës? Po ashtu, nga sqarimet e kryeshefit të ASK-së nuk arritëm të kuptojmë se pse nuk kanë zyrtarë përgjegjës për siguri të informatave. Gjithashtu pyeti se përveç blerjes se kompjuterëve nga ASK-ja, a është blerë edhe ndonjë server?

Mirlinda Sadiku, theksoi se gjatë vitit 2019, ASK-ja ka pasur mbi 370 zyrtarë të angazhuar si të punësuar me kontrata për shërbime të veçanta, e sipas raportit të auditorit këta zyrtarë në kontratat e punës se tyre nuk ka pasur datë të fillimit dhe as të mbarimit të punës. Po ashtu, disa nga këta zyrtarë kanë pasur qasje në domen pa kufizime dhe nuk ka pasur monitorim të aktiviteteve të tyre? Po ashtu, pyeti se a mendon ASK-ja me rastin e regjistrimeve të reja të pranojë zyrtarë me kësi lloj kontrata?

Kryetarja, tha se sfidë e institucioneve ka qenë dhe është mbajtja e kuadrove që kanë njohuri nga fusha e TI-së, ky problem i përcjellë të gjitha institucionet e sektorit publik. Po ashtu, pyeti për rregulloren për riorganizimin dhe sistematizimin të vendeve të punës brenda ASK-së.

Ilir Berisha, tha se deri në fund të qershorit 2021 do të përfundojë kjo rregullore.

Përfundim

KMFP-ja vendosi njëzëri që raporti i auditimit të performancës, të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve, të mos adresohet për seancë plenare, rekomandimet e komisionit i dërgohen vetëm entitetit të audituar.

4. Të ndryshme

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës së komisionit, si mbledhje e përbashkët me Komisionin e Arsimit të shqyrtohet, raporti i auditimit "Efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësimit profesional me nevojat e tregut të punës", me ç'rast znj. Mirlinda Sadiku, deputete, u caktua si raportuese, si edhe raporti i auditimit të performancës, procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industriale dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari". Raportuese për këtë raport, deputetja Jasmina Dediq, ose deputeti Enver Haliti në mungesë të saj.
Po ashtu, në mbledhjen e radhës së komisionit do të shqyrtohen dhe miratohen rekomandimet e komisionit për raportin e auditimit të performancës, zbatimi i rekomandimeve të raportit "Administrimi i programit për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike dhe vlerësimi i rezultateve", si edhe rekomandimet për raportin auditimit për Investimet në sistemin e TI-së në sektorin publik, nëse për këtë janë të gatshëm raportuesit.

Mbledhja e radhës u vendos të mbahet më 18 maj 2021, në orën 10.00.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.
E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit